

Vendim nr. 270 datë 11.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare
Marsida Xhaferllari, Anëtare
Marjana Semini, Anëtare

në datën 11.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 10 (V) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: VELI MEHAJ, përfaqësuar nga avokati Pjetër Deda, me prokurë.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 309 (86-2022-426), datë 21.09.2022 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2697, datë 20.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 15, pika 2, 41, 42, 43, 44, 49 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*); ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Holta Zaçaj, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Veli Mehaj është regjistruar si person fizik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) për ushtrimin e aktivitetit tregtar me objekt të veprimtarisë “Tregtim artikuj industriale, kaseta të ndryshme me pakicë”. Ky aktivitet ushtrohet nga kërkuesi në qytetin e Tiranës, në një ambient “lokal” të marrë me qira. Me qëllim reklamimin e mallit kërkuesi ka shfrytëzuar, përveç ambienteve të brendshme të njësisë së tregtimit, edhe ambientin jashtë saj, shkak për të cilin, gjatë periudhës 2017-2020, ai është bërë objekt i disa masave administrative për zënie të hapësirës publike (24 të tilla). Me procesverbalet e datave 12.09.2020 dhe 13.09.2020 të Policisë Bashkiake të Bashkisë Tiranë, kërkuesi është gjobitur me gjobë në vlerën 20,000 lekë dhe 5,000 lekë. Mbi bazën e ankimit të kërkuesit, Komisioni i Apelimit pranë Bashkisë së Tiranës, me vendimin nr. 45482, datë 17.09.2019, ka vendosur lënien në fuqi të tyre. Për rrjedhojë, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt kundërshtimin e vendimit të organit administrativ dhe anulimin e gjobave.

2. Me vendimin nr. 1365 (80-2020-1344), datë 06.07.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, duke shfuqizuar aktet administrative, procesverbalet e datave 12.09.2019 dhe 13.09.2020 të Policisë Bashkiake për vendosjen e gjobave ndaj kërkuesit dhe vendimi nr. 45482, datë 17.09.2019 i Komisionit të Apelimit pranë Bashkisë së Tiranës. Sipas gjykatës, pavarësisht barrës së provës që rëndon mbi organin publik për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, nuk provohet ekzistenca e faktit që mund të konsiderohet si kundërvajtje administrative, pra se kërkuesi ka zënë hapësirat publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia e Tiranës. Ky vendim është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet menjëherë.

3. Në vijim kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e palës së paditur, Policisë Bashkiake, Bashkia Tiranë, për ta dëmshtëpërblyer për dëmin e pësuar si rezultat i veprimeve të kryera në kundërshtim me ligjin, dëmin pasuror, jopasuror dhe fitimin e munguar, në vlerën 5,404,656 lekë, si dhe detyrimin për kthimin e shumave të paguara padrejtësisht.

4. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 1356, datë 04.05.2021, ka vendosur pranimin e pjeshëm të kërkesëpadisë, duke detyruar Policinë Bashkiake që të dëmshtëpërblejë paditësin (kërkuesin) për dëmin pasuror dhe jopasuror në shumën 4,327,388.54 lekë, si dhe rrëzimin e kërkesëpadisë për pjesën tjetër të objektit të saj, si të pabazuar në ligj e në prova. Sipas asaj gjykate, prania fizike periodike e inspektorëve të Bashkisë së Tiranës në ambientet ku ushtron aktivitetin kërkuesi, si dhe gjobat periodike, kanë sjellë mosfunksionimin normal të veprimtarisë së tij, që është përkthyer në rënie të xhiros

vjetore, sipas aktit të ekspertimit. Po kështu, sipas provave të administruara në gjykim, në vlerësimin e gjykatës ka rezultuar se kërkuesi ka pësuar edhe dëm shëndetësor. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur, Policia Bashkiake, duke kërkuar ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesëpadisë, si edhe kërkuesi, i cili ka kërkuar pranimin e plotë të saj.

5. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 309 (86-2022-426), datë 21.09.2022, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. 1356, datë 04.05.2021 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Sipas saj, kërkuesi nuk i ka kundërshtuar 24 dënimet administrative me gjobë, me përjashtim të dy dënimeve të vitit 2019, ndaj sjellja dhe veprimtaria e organit administrativ e formalizuar në këto akte administrative nuk mund të pranohet se është në tërësi e paligjshme bazuar në prezumime. Sipas asaj gjykate, pala paditëse do të legjitimohej të përfitonte shpërblimin e dëmit vetëm nëse do të pranohej e vërtetuar lidhja shkakësore ndërmjet dy veprimeve të paligjshme të palës së paditur dhe pasojave të pretenduara si dëme pasurore e jopasurore nga ana e palës paditëse. Ndaj këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesi, duke kërkuar ndryshimin e tij dhe të vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe pranimin e plotë të kërkesëpadisë.

6. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2697, datë 20.06.2024, ka vendosur mospranimin e rekursit, pasi nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara nga neni 58 i ligjit nr. 49/2012. Sipas tij, gjykata e apelit ka sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi duke bërë cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të dhe konkluzioni i asaj gjykate është rezultat i një analize tërësore dhe objektive të provave, duke i bërë analizë të hollësishme dispozitave të ligjit material që rregullojnë mosmarrëveshjen në gjykim, për rrjedhojë duke u dhënë përgjigje në mënyrë shteruese të gjitha shkaqeve të parashtruara në rekurs.

7. Në datën 16.09.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 23.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se është cenuar:

8.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

8.1.1. *Së drejtës së aksesit substancial*, pasi duke qenë se gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit kanë mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta për çështjen, Kolegji Administrativ duhej ta shqyrtonte atë në themel, duke

analizuar shkaqet e rekursit. Përkundër këtij fakti, Kolegji Administrativ është kufizuar në një konstatim formal të asaj që ka arsyetuar e analizuar gjykata e apelit, duke mos analizuar shkeljet ligjore të pretenduara nga kërkuesi.

8.1.2. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi arsyetimi i gjykatës së apelit është shkëputje e qëllimshme dhe tendencioze e lidhjes shkakësore juridike të akteve administrative (24 dënimeve me gjobë), pasi thjesht mosgoditja veçmas e atyre akteve nuk mund të prezumojë se veprimtaria e organit publik është e ligjshme në tërësinë e saj. Fakti që kërkuesi ka paguar disa gjoba nuk do të thotë se ka pranuar ligjshmërinë e tyre, ndërkohë që pagesa është bërë për të mos u penguar veprimtaria e tij tregtare. Shfuqizimi i dy akteve administrative me vendim të formës së prerë është tregues i paligjshmërisë edhe i akteve të mëparshme, për sa kohë që të gjitha aktet administrative të palës së paditur janë disponuar me motivacionin “zënie e hapësirës publike”, i cili është shpallur i paligjshëm me vendimin e formës së prerë nr. 1365, datë 06.07.2020 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Pasojat në dëm të shëndetit të kërkuesit, përveçse atyre ekonomike, nuk kanë ardhur vetëm dy prej akteve të shfuqizuara, por nga të 24-ra aktet administrative të dënimit me gjobë. Gjykata e apelit nuk mund të fshihet në petkat e institutit të parashkrimit të padisë për çdo akt administrativ të dhënë ndaj kërkuesit. Referuar parashikimeve të ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” jo vetëm jemi para një veprimi të paligjshëm të konfirmuar me vendim të formës së prerë, por edhe sikur të pranohej se organi publik ka vepruar në përmbushje të detyrave, kërkuesit i është shkaktuar një dëm i pabarabartë. Kolegji Administrativ, nga ana tjetër, nuk ka marrë parasysh vendimin e formës së prerë, zbatimi i të cilit është element i parimit të sigurisë juridike.

8.2. *E drejta për t’u rehabilituar*, pasi kërkuesi ka pasur pritshmëri të ligjshme nga vendimi i formës së prerë nr. 1365, datë 06.07.2020 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, që ka konstatuar dëmin e ardhur nga veprimet e paligjshme të palës së paditur. Gjykata e apelit nuk ka marrë parasysh dhe ka injoruar të gjitha faktet, aktet dhe provat shkencore e shkresore të paraqitura nga ana e ekspertëve të pavarur, të cilët kanë konfirmuar pa asnjë dyshim pretendimet e kërkuesit për dëmet e shkaktuara. Ky rëndim i pozitës së kërkuesit nuk është riparuar as nga Gjykata e Lartë.

8.3. E drejta për të fituar të ardhurat e jetesës me mjete të ligjshme, pasi me praninë periodike të saj në mjediset e aktivitetit tregtar të punës së kërkuesit Policia Bashkiake jo vetëm i ka shkaktuar atij dëm jopasuror, por është vërtetuar nga aktet e ekspertimit se ai ka humbur edhe aftësinë për punë pjesërisht në mënyrë të pakthyeshme (25%).

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

9. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë njëkohësisht kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

10. Në këtë këndvështrim, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi është palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi.

11. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kurse për sa u përket pretendimeve të parashtruara përpara Gjykatës, Kolegji vëren se pretendimet për cenimin e së drejtës për t’u rehabilituar dhe së drejtës për të fituar të ardhurat e jetesës me mjete të ligjshme kërkuesi nuk i ka ngritur më parë në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë, por i ka ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual. Për rrjedhojë në lidhje me këto pretendime ai konsiderohet se nuk ka shteruar mjetet juridike të ankimit.

12. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar,

ai i Gjykatës së Lartë, mban datën 20.06.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 16.09.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

13. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në disa aspekte të saj. Sipas kërkuetit është cenuar *e drejta e aksesit substancial*, për shkak se në prani të qëndrimeve diametralisht të kundërta të gjykatave të faktit, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë së Lartë duhej ta shqyrtonte çështjen në themel, duke analizuar shkaqet e rekursit të ngritura prej tij. Po kështu, kërkuesi ka pretenduar edhe cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i gjykatës së apelit është i paarsyetuar në drejtim të ligjshmërisë së akteve administrative të organit administrativ dhe lidhjes shkakësore mes veprimeve të këtij të fundit dhe pasojave të ardhura kërkuetit, kurse Gjykata e Lartë është kufizuar në një konstatim formal të asaj çfarë ka analizuar gjykata e apelit, duke mos marrë parasysh vendimin e formës së prerë që kishte shfuqizuar dy procesverbalet për caktimin e gjobave ndaj kërkuetit. Kolegji, referuar argumenteve të kërkuetit në lidhje me këto pretendime, duke mbajtur në konsideratë thelbin dhe natyrën e tyre, vlerëson t'i analizojë ato në vijim në drejtim të së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

B. Për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

14. Sipas kërkuetit, arsytimi i gjykatës së apelit është shkëputje e qëllimshme dhe tendencioze e lidhjes shkakësore juridike të akteve administrative (24 dënimeve me gjobë), pasi thjesht mosgoditja veçmas e atyre akteve nuk mund të prezumojë se veprimtaria e organit publik është e ligjshme në tërësinë e saj. Sipas tij, fakti që ka paguar disa gjoba nuk do të thotë se ka pranuar ligjshmërinë e tyre, ndërkohë që pagesa është bërë për të mos u penguar veprimtaria e tij tregtare. Sipas kërkuetit, shfuqizimi i dy akteve administrative me vendim të formës së prerë është tregues i paligjshmërisë edhe i akteve të mëparshme, për sa kohë që të gjitha aktet administrative të palës së paditur janë disponuar me motivacionin “zënie e hapësirës publike”, i cili është shpallur i paligjshëm. Kërkuesi ka pretenduar se pasojat në dëm të shëndetit të tij, përveçse pasojave ekonomike, nuk kanë ardhur vetëm dy prej akteve të shfuqizuara, por nga të 24-ra aktet administrative të dënimit me gjobë. Sipas tij, në kushtet që gjykatat e faktit kanë mbajtur qëndrime diametralisht të kundërta për çështjen, Gjykata e Lartë duhej ta shqyrtonte atë në themel, duke analizuar shkaqet e rekursit, ndërkohë që ajo gjykatë, përkundrazi, është kufizuar në një konstatim formal të asaj që ka arsyetuar e analizuar gjykata e apelit, duke mos analizuar shkeljet ligjore të pretenduara në rekurs.

15. Gjykata ka pohuar se neni 42 i Kushtetutës sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit përbën një aspekt të saj. Kjo e drejtë përfshin jo vetëm të drejtën për të vënë në lëvizje gjykatën, por edhe të drejtën për të pasur prej saj një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi (*shih vendimet nr. 31, datë 03.11.2022; nr. 3, datë 23.02.2016; nr. 52, datë 14.11.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, ajo ka theksuar se arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funkcioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 31, datë 29.05.2023; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 33, datë 08.12.2005 të Gjykatës Kushtetuese*). Po sipas Gjykatës, arsyetimi i kufizuar nuk cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, përderisa shpreh në thelb shkaqet e mospranimit të rekursit nga ana e kolegjit të Gjykatës së Lartë, gjatë shqyrtimit paraprak të tij në dhomën e këshillimit (*shih vendimet nr. 28, datë 01.11.2022; nr. 19, datë 07.07.2022; nr. 2, datë 11.02.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e tyre. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimet nr. 19, datë 01.04.2021; nr. 79, datë 14.12.2017; nr. 3, datë 26.01.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u takon vendimeve diametralisht të kundërta, Gjykata, bazuar në parimin e subsidiaritetit, si dhe në funksion të rolit të Gjykatës së Lartë si gjykatë e ligjit dhe kontrolluese e respektimit të standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, ka theksuar se kjo e fundit ka detyrimin t'u përgjigjet të gjitha pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura në rekurs kur këto gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes (*shih vendimin nr. 12 datë 15.03.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Nga ana tjetër kjo Gjykatë, në mënyrë konstante, ka pohuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Mënyra se si gjykatat e zakonshme kanë përcaktuar faktet dhe kanë interpretuar ligjin e zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes në shqyrtim para tyre nuk përbën lëndë kushtetuese, me përjashtim të rastit kur kjo mënyrë veprimi e gjykatës së zakonshme provohet se ka cenuar të drejta kushtetuese të individit, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit

të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 30, datë 29.05.2023; nr. 32, datë 03.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Kolegji, duke iu rikthyer rastit konkret në shqyrtim, vëren se me vendimin nr. 1365 (80-2020-1344), datë 06.07.2020, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur shfuqizimin e procesverbaleve të datave 12.09.2019 dhe 13.09.2020 të Policisë Bashkiake për vendosjen e gjobave ndaj kërkuesit. Sipas asaj gjykate, pavarësisht barrës së provës që rëndon mbi organin publik për të provuar ligjshmërinë e aktit administrativ, nuk provohet fakti se kërkuesi ka zënë hapësira publike dhe vetëm fakti i reklamimit të mallit jashtë njësisë së tij tregtare jo domosdoshmërisht prezumon faktin se janë zënë hapësirat publike. Ajo gjykatë ka arsyetuar se edhe nga procesverbalet objekt gjykimi nuk pasqyrohet asnjë rrethanë e cila të provojë se kërkuesi ka zënë hapësirat publike. Sipas gjykatës, kërkuesi nuk ka kryer ndonjë veprim që të vijë në kundërshtim me pikën 7 të nenit 3 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 156, datë 21.12.2018 “Për përcaktimin e disa kundërvajtjeve administrative dhe sanksionin që vendoset për to në territorin e Bashkisë Tiranë” dhe pala e paditur nuk ka arritur të provojë ekzistencën e faktit që mund të konsiderohet si kundërvajtje administrative, pra se kërkuesi ka zënë hapësirat publike në kundërshtim me rregullat e vendosura nga Bashkia e Tiranës.

19. Mbi bazën e këtij vendimi kërkuesi ka vënë në lëvizje procesin gjyqësor objekt shqyrtimi duke kërkuar shpërblimin e dëmit të shkaktuar atij nga veprimet e kryera në kundërshtim me ligjin nga Policia Bashkiake. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë dhe detyrimin e Policisë Bashkiake të Bashkisë Tiranë, që të dëmshpërblejë kërkuesin për dëmin pasuror dhe jopasuror, duke vlerësuar se prania fizike periodike e inspektorëve të palës së paditur në ambientet ku ushtron aktivitetin kërkuesi, si dhe gjobat periodike kanë sjellë mosfunksionimin normal të veprimtarisë së tij, që është përkthyer në rënie të xhiros vjetore, sipas aktit të ekspertimit. Sipas asaj gjykate, faji i palës së paditur konsiston në faktin se duke vepruar në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, ajo ka vendosur në mënyrë periodike gjoba ndaj kërkuesit, një pjesë e të cilave janë shfuqizuar nga gjykata. Po kështu, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar, referuar provave të administruara në gjykim, se kërkuesi ka pësuar edhe dëm shëndetësor dhe kjo situatë i ka krijuar shqetësim, stres, mospërqendrim në punë dhe komunikim më pak cilësor me klientët, kurse në aspektin fizik ka përjetuar gjumë të trazuar, dhimbje kraharori e kockash, si dhe përkeqësim të dukshëm të të ardhurave, duke çuar në shtim të problemeve financiare.

20. Mbi ankimin e palëve në gjykim, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se kërkuesi nuk i ka kundërshtuar të 24-ra dënimet administrative me gjobë për vitet 2017 - 2020, me përjashtim të dy dënimeve të dhëna në vitin

2019, ndaj sjellja dhe veprimtaria e organit administrativ e formalizuar në akte administrative nuk mund të pranohet se është në tërësi e paligjshme bazuar në prezumime. Sipas asaj gjykate, aktet administrative që nuk janë kundërshtuar në gjykatë janë të ligjshme dhe as organi administrativ kompetent, as gjykatat nuk i kanë revokuar ose shfuqizuar ato dhe nuk është vërtetuar lidhja shkakësore ndërmjet dy veprimeve të paligjshme të palës së paditur dhe pasojave të pretenduara si dëme pasurore e jopasurore nga ana e palës paditëse.

21. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi, me arsyetimin se përfundimi i arritur nga Gjykata Administrative e Apelit është rrjedhojë e respektimit dhe zbatimit të drejtë të parimeve të gjykimit administrativ, si dhe i kërkesave të ligjit procedural dhe e një analize tërësore dhe objektive të provave. Sipas Kolegjit Administrativ, gjykata e apelit ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, duke garantuar zhvillimin e një hetimi të plotë dhe të gjithanshëm të çështjes, duke sqaruar plotësisht rrethanat dhe faktet që lidhen me mosmarrëveshjen objekt gjykimi, si dhe duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve që lidhen me të. Në vlerësimin e Kolegjit Administrativ shkaqeve të parashtruara në rekurs u është dhënë përgjigje në mënyrë shteruese nga ana e gjykatës së apelit dhe pjesa e pretendimeve në rekurs që ngre çështje të vlerësimit të provave, del jashtë juridiksionit rishikues dhe ekskluzivisht ligjor të Gjykatës së Lartë.

22. Kolegji, bazuar në standardet e mësipërme kushtetuese, si edhe referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, vëren se kërkuesi ka ushtruar lirisht të drejtën e ngritjes së padisë, sikurse edhe të drejtën e ankimit e të rekursit dhe gjykatat e vëna në lëvizje prej tij kanë analizuar pretendimet e parashtruara përpara tyre, duke u dhënë atyre përgjigje të arsyetuar. Vendimet gjyqësore të kundërshtuara rezultojnë të përmbajnë në mënyrë të plotë rrethanat e çështjes, arsyetimin e gjykatave më të ulëta, shkaqet e ngritura në ankim dhe rekurs nga kërkuesi, ligjin e zbatueshëm, si dhe analizën e dispozitave të zbatueshme ku është mbështetur qëndrimi i shprehur në dispozitiv. Kolegji vlerëson se arsyetimi i vendimeve objekt i ankimit kushtetues individual në drejtim të mënyrës se si kanë vlerësuar pretendimet e kërkuesit nuk rezultojnë të jetë arbitrar ose haptazi i paarsyeshëm, pra që të bjerë ndesh me konceptin e gjykimit të drejtë ose të mos respektojë standardet kushtetuese të një vendimi të arsyetuar. Për rrjedhojë, edhe fakti që Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkuesi nuk është i mjaftueshëm në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim procesin gjyqësor të zhvilluar nga ajo gjykatë.

23. Për sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimet e kërkuesit për cenimin e së drejtës së aksesit të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor janë haptazi të pabazuara.

24. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, bazuar në nenet 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.